



Prishtinë: 18.07.2012

Kodi i ZRRE-së: V\_423\_2012

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_772\_04\_12

### **Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kreut IV, nenit 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_772\_04\_12**; dhe
5. Ankesën e KEK-ut me datë 08.05.2012.

**Në mbledhjen e mbajtur më 18 korrik 2012 nxorri këtë:**

### **VENDIM**

- I **REFUZOHET** ankesa e KEK-ut ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin Refit Mifatri (shifra në KEK: DPR - 103503), nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_772\_04\_12 i datës 25.04.2012.

### **Arsyetim**

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut me datë 15.09.2010 kanë bërë rikyçjen e konsumatorit si dhe kanë vulosur njehsorin elektrik me vulë distributive nr. C00018361, si dhe kanë evidentuar që njehsorit elektrik i mungojnë dy vula shtetërore dhe i njëjti duhet të dërgohet në kalibrim.

Pas inspektimit të parë punëtorët e autorizuar të KEK-ut me datë 03.11.2010 kanë dalur te konsumatori dhe kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 12380854 dhe kanë vendosur për matje njehsorin e vet elektrik nr. 47443830.

Pas ndërrimit të njehsorit elektrik nga punëtorët e autorizuar të KEK-ut dhe dërgimit në qendrën e kalibrimit punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 12380854, ku është konstatuar se njehsorit elektrik vulat (bllombat) shtetërore i mungojnë, nga ana e jashtme dëmtime tjera nuk ka si dhe numëruesi i njehsorit elektrik është i manipuluar.

Me datë 18.05.2011 Departamenti i Faturimit në KEK e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR11HP09946 në vlerë prej 270.88€.

Pas ngarkesës së KEK-ut për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike në vlerë prej 456.44€, konsumatori ka parashtruar ankesë në KEK. Departamenti për konsumator në KEK ka shqyrtuar lëndën e konsumatorit ku edhe ka refuzuar ankesën e tij. Konsumatori pas marrjes së përgjigjës nga ana e KEK-ut, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e



Konsumatorëve në ZRRE me të cilin ka kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve ka bërë shqyrtimin e ankesës së konsumatorit dhe me datë 25.04.2012 ka nxjerr vendim duke **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që të shkarkoj konsumatorin nga fatura e shfrytëzimit të paautorizuar (rikthimit të humbjeve) DPR11HP09946 e datës 18.05.2011 në vlerë prej 270.88€

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 08.05.2012 KEK-u ka parashtuar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, me të cilën ka kundërshtuar pjeshëm vendimin e DMK-së nr. **ZRRE/DMK\_V\_772\_04\_12** të datës 25.04.2012, dhe njëherit ka propozuar që aprovet kundërshtimi i KEK-ut dhe borxhi i theksuar më sipër të ngelet kontest deri në përfundimin e të gjitha procedurave ligjore.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 18 korrik 2012 ka analizuar dëshmitë e paraqitur nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit procesverbalin e kalibrimit.

Gjatë analizës së lëndës së konsumatorit Bordi ka vërejtur se KEK –u e ka ngarkuar konsumatorin duke u bazuar vetëm në konstatimet teknike të bëra në procesverbalin e kalibrimit.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe shpenzimin e energjisë elektrike me njehsor të vjetër dhe me njehsor të ri ka ndryshim, dhe ky ndryshim në energjisë elektrike ka të bëjë me disa muaj ku KEK-u e ka faturuar me shpenzim zero dhe se ky shpenzim zero ka vazhduar edhe pas ndërrimit të njehsorit elektrik. Mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën 08/2002 deri më 12/2006 është 1110 kWh/muaj ndërsa për periudhën 01/2007 deri më 04/2010 është 507 kWh/muaj. Sipas rrjedhës së energjisë elektrik të regjistruar konstatohet se konsumatori nga periudha 05/2010 deri më 11/2010 kur edhe është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik nuk ka fare shpenzim të energjisë elektrike.

Po ashtu është analizuar edhe kontratën shitblerjes së pronës së paluajtshme, e vërtetuar në gjykatë ku sipas kontratës konsumatori Refit Miftari nuk ka pasur në posedim pronën e cila është furnizuar përmes njehsorit elektrik nr. 12380854, pasi që njehsori elektrik është ndërruar me datë 03.11.2010, dhe se procesverbali i ndërrimit të njehsorit elektrik është evidentuar në emër të konsumatorit Kujtim Vokrii ndërsa lidhja e kontratës për shitblerje është bërë me datë 30.11.2010.

Sa i përket kundërshtimit të KEK-ut në ankesë që të merret bazë vetëm procesverbali i kalibrimit për të anuluar pjesërisht vendimin e DMK-së, Bordi i ZRRE-së pas shqyrtimit të këtij procesverbali ka vlerësuar se konstatimet e bëra në procesverbalin e kalibrimit nuk kanë qenë bindëse për të vërtetuar atë çka është theksuar në procesverbal. Sipas nenit 8, paragrafi 8.3 i Procedurës për Identifikimin dhe Parandalimin e Shfrytëzimit të Paautorizuar të Energjisë elektrike theksohet se, konstatimet e parregullsisë funksionale të njehsorit elektrik të konstatuara në laboratorin e kalibrimit nuk mund të përdoren si provë e vetme meritore për ngarkimin e konsumatorit me faturën e rikthimit të energjisë së humbur.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 18.07.2012 ka analizuar ankesën e KEK-ut dhe vendimin e nxjerrë nga ana e DMK-së nr. ZRRE/DMK\_V\_772\_04\_12, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur në diapozitivin e këtij vendimi.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar